



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1652/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Bersha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, sipas autorizimit e përfaqëson S.K., kundër debitorit HIG Energy Sh.A., me seli në Prishtinë, Mati 1, me bazë juridike përmbarimore, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1070/22 të datës 19.09.2023, me datën 08.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A. me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1070/22 të datës 19.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1070/22 të datës 19.09.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit HIG Energy Sh.A., dhe e ka anuluar Urdhrin përmbarimor P.nr.70/21 i datës 25.01.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj dhe përfundon procedurën në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa dhe aktvendimin e kundërshtuar ta prishë dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose ta ndryshojë aktvendimin e atakuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” sh.a, ka caktuar urdhrin përmbarimor P.nr.70/21 i datës 25.01.2021, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme - Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit me shifër K033646, me të cilin është obliguar debitori që në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 3,262.98 euro, me kamatë ligjore 8% si dhe shpenzimet përmbarimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se në tërësi i kundërshton pretendimet e kreditorit si të paqëndrueshme juridikisht për arsye se fatura mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk janë të përshtatshme për përmbarim. Për faktin se propozimit për përmbarim i është bashkangjitur kartela financiare e konsumatorit e cila nuk paraqet dokument të besueshëm dhe gjithashtu asnjë nga këto fatura nuk janë dorëzuar debitorit, dhe fatura e muajit tetor 2020 në shumë prej 4,114.62 euro nuk qartëson se për cilën periudhë kohor është borxhi. Gjithashtu debitori ka paguar këstet mujore sipas faturës që lë të kuptohet është duke përmbushur borxhin ndaj kreditorit. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi, të priset Urdhri Përmbarimor, dhe të detyrohet kreditori që të ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, përfshirë taksën për administrimi dhe shpenzimet e tjera përfshirë edhe shpenzimet e debitorit.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, të pa argumentuar si dhe pa mbështetje në ligj dhe prova. Tutje ka theksuar se prapësimi i debitorit është i paqartë dhe kundërthënës, ngase në këtë rast nuk kemi të bëjmë me parashkrim të bporxhit dhe nuk qëndron se debitori ka bërë pagesa të pjeshme të cilan kanë dërguar në ndërprerje të afatit të parashkrimit. Andaj, ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1070/22 të datës 19.09.2023 me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit HIG Energy Sh.A., dhe e ka anuluar Urdhrin përmbarimor P.nr.70/21 i datës 25.01.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj dhe përfundon procedura në këtë çështje përmbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata thekson se nga koha e inicimit të procedurës përmbarimore e deri në kohën e vendosjes sipas prapësimin, debitori ka paguar borxh tek kreditori shumë prej 4,400.00€, meqenëse borxhi i kërkuar nga kreditoi kap vlerën prej 3,262.98€ pas inicimit të procedurës përmbarimore, rezulton se i njëjti ka përmbushur në tërësi detyrimin që kërkohet nga kreditori. Gjykata erdhi te ky konstatim se të gjitha pagesat e bëra nga debitori i referohen faturës nr.P02237019088329 në vlerë prej 4,761.00€. Gjykata vendimin e saj e referon ne nenin 29 pika 1., 3 dhe neni 37 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm –Ekstrakti nga librat afariste me shifër K033646 për periudhën 2019-

2021, e që nga pagesat bankare të dëshmuara nga debitori me datë 06.02.2021, 04.03.2021, 02.04.2021, 05.05.2021, 07.06.2021, 06.0.2021 05.08.2021, 05.10.2021, 10.11.2021, 10.01.2021, rezulton se debitori ka paguar borxhin ndaj kreditorit për periudhën kohore brenda së cilës është kërkuar borxhi nga kreditori në shumën prej 3,262.98€

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se me të drejt dhoma e shkallës së parë ka zbatuar ligjin, duke u referuar në dispozitat e nenit 29 par.1, dhe 3 të LPP-së, neni 37 të LPP-së, të cilat dispozita ligjore përcaktojnë se kur dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim dhe dokumenti që duhet bashkangjitur propozimit për përmbnim. Në rastin konkret gjendja e fakteve në shkresat e lëndës dëshmon se debitori ka përmbush detyrimin ndaj kreditorit për periudhën kohore të kërkuar sipas dokumentit përmbnimor-kartelës së konsumatorit K033646.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të kësaj gjykate e pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbnimore apo kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë i analizoi pretendimet e kreditorit por vlerëson se i njëjti nuk i ka kontestuar pagesat bankare të debitorit të paguara në emër të borxhit për periudhën kohore të kërkuar, dhe nuk ka paraqit pretendime ankimore të bazuara që do të ndryshojnë gjendjen faktike të konstatuar nga shkresat e lëndës.

Përndryshe në procedurën përmbnimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbnimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbnues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbnimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1652/23 me datë 08.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha